VENDIM
Nr. 96, datë 15.3.2023

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 47, DATË 20.2.2023, "MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 136, SERIA T11P, PËR VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË 'ERMA M.P.' SHPK"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 95 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; neneve 7, 8 dhe 9 të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.4.2017; si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordit i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1064/3 prot., datë 13.3.2023, të përgatitur nga grupi i punës "Mbi përfundimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore për pagesat e rregullimit të vitit 2022 të pashlyera ndaj ERE-s",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 47, datë 20.2.2023, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 136, seria T11P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Erma M.P." sh.p.k., për arsye të mosshlyerjes në afat të pagesës rregullatore për vitin 2022 të licencës për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe po ashtu nuk kishte depozituar asnjë dokument apo argument në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 959 prot., datë 27.2.2022, shoqëria është njoftuar për vendimin e Bordit të ERE-s nr. 47/2023, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare (statement) të ERE-s rezulton se kjo debi është shlyer në datën 27.2.2023.

- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijeni të subjektit, rezulton se shoqëria "Erma M.P." sh.p.k. i ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit dhe nuk është më debitore ndaj ERE-s.

- Në nenin 9, germa "a" të "Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, parashikohet se, Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës".

- Në nenin 95 të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", parashikohet, se: organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur. Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe shlyerjes në masën 100% vlerës së debisë nga shoqëria "Erma M.P." sh.p.k.

- Vërtetimi i shlyerjes së pagesës të prapambetur, fakton ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i është vendosur masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut që çoi në marrjen e masës për fillimin e procedurës për heqjen e licencës, dhe duke qenë se objekti për të cilin filloi procedura për heqjen e licencës së të licencuarit nuk ekziston më, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të Bordit të ERE-s nr. 47/2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 47, datë 20.2.2023, "Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 136, seria T11P, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë "Erma M.P." sh.p.k.".

2. Të shfuqizojë vendimin e Bordit të ERE-s nr. 47, datë 20.2.2023.

3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë "Erma M.P." sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti